



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E LEJEVE MJEDISORE DHE VNM**

AN221120230004

Tiranë, më: 16.01.2024

**Komisioni 06**

**DEKLARATE MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

**Lëshimin e Deklaratës Mjedisore negative, për Zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:**

**Personi juridik:** “RO-GENT-1” sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** L06510401F

**Adresa e selisë:** Lagjja ”Gjeologu”, objekt privat me nr. pasurie 2/407, Z.K 8612, Bulqizë.

**Personi përgjegjës:** Arben Çupi

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzim i mineralit të kromit në qiell të hapur dhe minierë nëntokësore**”.

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurorë dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Objekti “Takimi i parë”, Zona Minerare nr.693, Bulqizë, Qarku Dibër.

**Të dhëna teknike:**

Sipërfaqja (sipas Lejes Minerare): 2 km<sup>2</sup>

*(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr.10440, date 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

*Refuzimi i kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse*

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr.10440, datë: 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshte po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:**

*Drejtoritë teknike të ministries shprehin mendimin si më poshtë vijon:* Referuar kërkesës së subjektit "Ro-Gent-1" sh.p.k. me nr AN221120230004 aplikimi, datë 22/11/2023 në lidhje me kërkesën për Deklaratë Mjedisore për procedurën e thelluar të VNM-së për projektin "Shfrytëzim i mineralit të kromit në qiell të hapur & minierë nëntokësore", me vendndodhje në Bulqizë, Dibër, bazuar në pikën 11, të Kreut II, të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore", të ndryshuar, drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:

#### ***Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet me rekomandimet si më poshtë vijon:***

Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ushtrimit të aktivitetit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"; - Të spërkatën rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit"; - Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit". - Me qëllim mbrojtjen e mjedisit, përdorimi i lëndëve plasëse, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil". - Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.

• Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese sugjeron që zhvilluesi duhet të përmbushë detyrimet për menaxhimin e mbetjeve, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, në fushën e mbetjeve, si më poshtë vijon:

• Gjatë zhvillimit të aktivitetit minerar mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të VKM nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".

• Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

• Të respektohen kërkesat e VKM nr. 418, date 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim".

• Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të VKM nr. 402, datë 30.06.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve".

- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.

- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet VKM nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar. Në raport citohet VKM nr.175, datë 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”, i cili është shfuqizuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

#### ***Drejtoria e Natyrës dhe e Pyjeve sugjeron si më poshtë vijon:***

-Sa i takon sektorit të pyjeve: Shprehet kundër miratimit, për arsye sepse leja mieralet e dhënë nuk është konsultuar dhe bashkërenduar me institucionet përkatëse përgjegjëse për pyjet.

-Kjo bie ndesh me pikën 6, të nenit 10, të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”.

-Bazuar në nenin 12, të ligjit 57/2020, pyjet janë pasuri kombëtare dhe funksioni i tyre prevalon mbi çdo interes;

-Sipërfaqja pyjore ku do të ndërhyhet është shumë e madhe (sipërfaqja e lejes mirerare është 2 km<sup>2</sup>), çka është e papranueshme;

- Informacionin nuk është marrë dhe sqaruar sipas kërkesave të VKM nr.686, datë 29.07.2015 dhe nuk analizohen alternativat dhe mënyrat e ndërhyrjeve (p.sh.minierë nëntokësore) në këto sipërfaqe;

- Në konsultimin me publikun gjejmë këto probleme:

- nuk jepet kush ka diskutuar dhe mendimet e tyre;
- mungon pjesmarrja e strukturave përgjegjëse për pyjet në bashkisë;
- nuk ka dakordësinë e bashkisë;
- nuk kemi asnjë të dhënë për afishimin e njoftimit;
- mungon mendimi i ARM.

-Sa i takon sektorit të mbrojtjes së natyrës: Shprehet se sugjeron që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve: Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar; Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe të bëj rehabilitimin e zonës me mbjellje pemësh.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. Të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:** Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti: “Shfrytëzim i Mineralit të Kromit në qiell të hapur & Minierë Nëntokësore”, objekti “Takimi i parë”, Zona Minerare Nr. 693, Bulqizë, Qarku Dibër, me zhvillues “RO-GENT-1” dhe aplikues “Go - Green Studio”, me nr. Aplikimi AN221120230004, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shprehet:** Në vijim të aplikimit të depozituar në sistemin elektronik të lejeve, me Nr. aplikimi AN221120230004, për të cilin keni kërkuar mendim për VNM-në e thelluar për Deklaratë Mjedisore, me subjekt zhvillues shoqëria “Ro Gent-1”, ju bëjmë me dije se:

-Shoqëria “Ro Gent-1” sh.p.k., ka aplikuar për shndërrimin e Lejes minerare të kërkim-zbulimit Nr.1903, datë 22.12.2020, në leje minerare shfrytëzimi, për mineralin e kromit, në objektin "Takimi i Parë", Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

-Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit Nr. 10 304 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shprehemi dakord për vazhdimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë së mësipërme me lejen përkatëse në funksion të veprimtarisë minerare në zonën e licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

**Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet:** Pas shqyrtimit të dosjes së VNM Thelluar për subjektin “Ro-Gent-1” sh.p.k, për veprimtarinë “Shfrytëzim i Mineralit të Kromit në qiell të hapur & Miniere Nëntokësore”, me vendndodhje në Objektin “Takimi i parë”, Zona Minerare nr.693, Bulqizë, Qarku Dibër, Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër shprehet se implementimi i projektit të propozuar do të ketë ndikim në mjedis duke ndikuar në: - Rritjen e erozionit të zonës. - Degradimin e bimesisë (flores) të zonës dhe humbje të habitateve natyrore. - Shqetësim të kafsheve të egra (faunes) të zonës, për shkak të demtimit dhe humbjes së habitateve të tyre natyrore dhe për shkak të zhurmës së krijuar nga përdorimi i lëndës plasuese gjatë nxjerrjes së mineraleve.

Gjithashtu sygjerojme zbatimin e rekomandimeve të listuara më poshtë:

-Në të gjitha rastet që do të ketë ndërhyrje në mjedis do të duhet të ruhet vegjetacioni si edhe bimësia karakteristike zonale duke mos dëmtuar në asnjë rast peizazhin natyror të zonës së marrë në studim.

- Në rastet se gjatë venies në zbatim të projektit dhe funksionimit të tij do të verëhet prania e flores dhe e faunes të cilat janë specie të rrezikuara ose endemike të tregohet kujdes i veçantë për të mos dëmtuar ato.

- Gjatë hapjeve të rrugëve të reja subjekti të ketë kujdes bimesinë në zonën ku do të ndërhyjë, duke pasur parasysh se në çdo rast të prerjeve apo shkuljeve të pemeve, gjatë fazës së rehabilitimit ato të zëvendësohen me po të njëjtat lloj.

- I gjithë territori i shfrytëzimit të rrethohet me rrjete për të parandaluar hyrjen e kafsheve të zonës.

- Kamionat transportues të jenë të pajisura me bordura mbrojtëse dhe me mushama për të shmangur rënien aksidentale të gurit dhe përhapjen e pluhurave. Të pastrohen gomat e makinave kur të dalin nga territori.

- Të zbatohen standardet dhe praktikat më të mira gjatë përdorimit të lëndëve plasuese. Punëtorët të pajisen me kufje për mbrojtjen nga zhurma.

- Të përdoren sprucator për të shmangur përhapjen e grimcave të pluhurave si pasoje e shpërthimeve për kërkimin e mineralit të kromit.

- Të behet trajtimi i ujerave të ndotur me gropë dekantimi.

- Të hapen kanale drenazhimi të ujerave atmosferike në sheshet e punës të çdo galerie, që ujerat të mos rrjedhin në zonën që do të shfrytëzohet, për të mos u kontaminuar me kromin.

- Të parashikohen masat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh.

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

Dëgjesa me publikun u zhvillua në datën 17.11.2023. Morën pjesë banorë nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Agjencia Rajonale e Mjedisit. Eksperti ka firmosur formularin e konsultimit me publikun në zbatim të Vendimit nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”;

## **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:**

*Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve shprehet kundër miratimit me arsyetimin se:*

- Leja Minerare e dhënë nuk është konsultuar dhe bashkërenduar me institucionet përkatëse përgjegjëse për pyjet. Kjo bie ndesh me pikën 6, të nenit 10, të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”.
- Bazuar në nenin 12, të ligjit 57/2020, pyjet janë pasuri kombëtare dhe funksioni i tyre prevalon mbi çdo interes;
- Sipërfaqja pyjore ku do të ndërhyhet është shumë e madhe (sipërfaqja e lejes minerare është 2 km<sup>2</sup>), çka është e papranueshme;
- Informacioni nuk është marrë dhe sqaruar sipas kërkesave të VKM nr.686, datë 29.07.2015 dhe nuk analizohen alternativat dhe mënyrat e ndërhyrjeve (p.sh.minierë nëntokësore) në këto sipërfaqe;
- Në konsultimin me publikun gjejmë këto probleme:
  - nuk jepet kush ka diskutuar dhe mendimet e tyre;
  - mungon pjesmarrja e strukturave përgjegjëse për pyjet të bashkisë:
  - nuk ka dakordësinë e bashkisë;
  - nuk kemi asnjë të dhënë për afishimin e njoftimit;
  - mungon mendimi i ARM.

Për sa më sipër, referuar mendimit të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedisit, propozojmë lëshimin e Deklaratës Mjedisore negative.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ARTA DOLLANI**

**MINISTRI**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

*Konceptoi:*

*Pranoi:*

**1.Anex 1.Harta dhe koordinatat**

